

## Raporti i Audituesit

Mbledhja e Pergjithshme e Ortakeve :  
"KREATX" SH.P.K. ,  
Rruga "Sami Frasheri" ,  
Tirane - Albania


### *Opinion*

Unë kam audituar pasqyrat financiare bashkëlidhur të Shoqërisë "KREATX" sh.p.k. Tirane, (Shoqëria) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31 Dhjetor 2016, pasqyrën e ardhurave dhe shpenzimeve gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tim pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, të marra në tërësi dhe në të gjithë aspektet materiale, në përputhje me Ligjin nr. 9228 date 29 Prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", dhe me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara, të shpallura me urdhërin e Ministrit të Financave nr 64 dt 22.07.2014 "Për shpalljen e detyrueshme të tyre", pozicionin financiar të shoqërisë "KREATX" sh.p.k.Tirane, me 31 Dhjetor 2016 dhe performancën financiare dhe të fluksit monetar për periudhën kontabël të mbyllur në këtë datë, të përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

### *Bazat për opinionin*

Unë e kreja auditimin në përputhje me Standardet Nderkombëtare të Auditimit (SNA-te). Përgjegjësitë e mia sipas këtyre standardeve janë pershkruar në mënyrë me të detajuar në seksionin e raportit ku jepet Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Unë jam i pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Republikën e Shqipërisë, dhe kam përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Unë besoj se evidenca e auditimit që kam marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për t'u përdorur si baze në dhënien e opinionit tim të audituesit.



### ***Përgjegjësia e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare***

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare që japin një pamje të vërtetë e të drejtë në përputhje me Ligjin nr. 9228 date 29 Prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe për ato kontrole të brendëshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, goftë për shkak mashtrimit apo gabimit

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijmësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijmësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijmësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetin, ose nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

### ***Përgjegjësia e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare***

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo të gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Firma : Lavdimir Fusha  
Eksperti Kontabël i Rregjistruar

*Lavdimir Fusha*  
*Fusha*

Datë : 30 Mars 2017



Adresa: Rr. Bulv "Gjergj Fishta", Nd. 16, H.9, Ap. 20,  
Njesia Bashkiake Nr. 10, Kodi Postar 1001 ,  
Tiranë -Albania  
Tel: + 2 427 019 ,  
Mob. 0692067870  
E-mail: lavdimir.fusha@albanianaudit.com



### **Shtojcë e Raportit të Audituesit.**

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-te, në ushtrojme gjykimin profesional dhe ruajme skepticismin profesional gjatë gjithë auditimit. Në gjithashtu:

- Identifikojme dhe vleresojme rreziqet e anomalise materiale, qofte për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojme dhe kryejme procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidence auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vleresojme përshtatshmerinë e politikave kontabel të përdorura dhe arsyeshmerinë e çmuarjeve kontabel dhe të shpjegimeve përkatëse të bërë nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmerinë e përdorimit të bazës kontabel të vijmesisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse në arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri në duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të përshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarja ose kushtet të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërprejë veprimtarinë.
- Në komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që në mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Firma : Lavdimir Fusha  
Eksperti Kontabël i Rregjistruar

*Lavdimir Fusha*  
*30 Mars 2017*

Datë : 30 Mars 2017

Adresa: Rr. Bulv "Gjergj Fishta", Nd. 16, H.9, Ap. 20,  
Njesia Bashkiake Nr. 10, Kodi Postar 1001,  
Tiranë -Albania  
Tel: + 2 427 019 ,  
Mob. 0692067870  
E-mail: lavdimir.fusha@albanianaudit.com



**Kreatx Shpk**  
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME  
31 DHJETOR 2016 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

*SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET*

---

**KREATX Shpk**  
**NIPT L12121023B**  
Selia: Rr. Sami Frasheri  
Tiranë – Shqipëri

**Pasqyrat Financiare për periudhën e mbyllur me 31 Dhjetor 2016**

Tiranë, 29 Mars 2017

**Kreatx Shpk**  
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME  
31 DHJETOR 2016 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

---

**Përmbajtja**

1. Bilanci Kontabël
2. Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve
3. Pasqyra e flukseve monetare
4. Pasqyra e ndryshmeve në kapital
5. Shënime

**Kreatx Shpk**  
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME  
31 DHJETOR 2016 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

**Bilanci Kontabel**

| <b>AKTIVET</b> |  | Viti 2016         | Viti 2015         |
|----------------|--|-------------------|-------------------|
| <b>I</b>       | <b>AKTIVET AFATSHKURTËRA</b>                         |                   |                   |
| <b>1</b>       | <b>Aktive monetare</b>                               |                   |                   |
| (i)            | Depozita ne banke dhe ne llogari te tjera            | 774,836           | 3,953,315         |
| (ii)           | Para ne dore (arke)                                  | 573,720           | 850,000           |
|                | <b>Totali 1</b>                                      | <b>1,348,556</b>  | <b>4,803,315</b>  |
| <b>2</b>       | <b>Investime</b>                                     |                   |                   |
| (i)            | Ne tituj pronesie te njesive ekonomike brenda grupit |                   |                   |
| (ii)           | Aksionet e veta                                      |                   |                   |
| (iii)          | Te tjera Financiare                                  |                   |                   |
|                | <b>Totali 2</b>                                      | <b>0</b>          | <b>0</b>          |
| <b>3</b>       | <b>Aktive te tjera financiare afatshkurtra</b>       |                   |                   |
| (i)            | Llogari/Kerkesa te arketueshme                       | 50,286,637        | 4,569,474         |
| (ii)           | Llogari/Kerkesa te tjera te arketueshme              | 37,153            | 9,073,810         |
| (iii)          | Instrumente te tjera borxhi                          |                   |                   |
|                | <b>Totali 2</b>                                      | <b>50,323,790</b> | <b>13,643,284</b> |
| <b>4</b>       | <b>Inventari</b>                                     | 0                 | 1,055,996         |
|                | <b>Totali 3</b>                                      | <b>51,672,346</b> | <b>19,502,596</b> |
| <b>5</b>       | <b>Aktive biologjike afatshkurtra</b>                |                   |                   |
| <b>6</b>       | <b>Aktivet afatshkurtra te mbajtura per shitje</b>   |                   |                   |
| <b>7</b>       | <b>Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra</b>           | 507,048           |                   |
|                | <b>TOTAL I AKTIVEVE AFATSHKURTËRA ( I )</b>          | <b>52,179,394</b> | <b>19,502,596</b> |
| <b>II</b>      | <b>AKTIVET AFATGJATA</b>                             |                   |                   |
| <b>1</b>       | <b>Investimet financiare afatgjata</b>               |                   |                   |
| <b>2</b>       | <b>Aktive afatgjata materiale</b>                    | 5,022,213         | 2,049,998         |
| (i)            | Pajsje kompjuterike                                  | 2,439,205         | 1,183,875         |
| (ii)           | Mobilje dhe pajsje zyre                              | 2,583,008         | 866,123           |
| <b>3</b>       | <b>Aktive biologjike afatgjata</b>                   |                   |                   |
| <b>4</b>       | <b>Aktive afatgjata jomateriale</b>                  |                   |                   |
| <b>5</b>       | <b>Kapitali I nenshkruar i papaguar</b>              |                   |                   |
| <b>6</b>       | <b>Aktive Tatimore te shtyra</b>                     |                   |                   |
|                | <b>TOTAL I AKTIVEVE AFATGJATA ( II )</b>             | <b>5,022,213</b>  | <b>2,049,998</b>  |
|                | <b>TOTALI I AKTIVEVE ( I + II )</b>                  | <b>57,201,607</b> | <b>21,552,593</b> |





**Kreatx Shpk**  
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUdhËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME  
31 DHJETOR 2016 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

| <b><u>DETYRIMET DHE KAPITALI</u></b>                            | <b>Viti 2016</b>  | <b>Viti 2015</b>  |
|---|-------------------|-------------------|
| <b>I DETYRIMET AFATSHKURTËRA</b>                                |                   |                   |
| 1 Titujt e Huamarrjes   |                   |                   |
| 2 Detyrime ndaj Institucioneve te kredise                       |                   |                   |
| 3 Arketime ne Avance per porosi                                 |                   |                   |
| 4 Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit                   | 7,887,041         | 4,076,356         |
| 5 Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit             |                   |                   |
| 6 Te pagueshme ndaj punonjesve                                  | 611,208           | -                 |
| 7 Te pagueshme per detyrime tatimore dhe Sigurimet Shoq & Shend | 4,213,392         | 3,337,601         |
| 8 Te tjera te pagueshme   | 5,531,455         |                   |
| <b>Te pagueshme per shpenzime te konstatuara</b>                |                   |                   |
| <b>Te ardhura te shtyra</b>                                     |                   |                   |
| <b>Provizione</b>   |                   |                   |
| <b>TOTAL I DETYRIMEVE AFATSHKURTËRA ( I )</b>                   | <b>18,243,095</b> | <b>7,413,957</b>  |
| <b>II DETYRIMET AFATGJATA</b>                                   |                   |                   |
| 1 Titujt e Huamarrjes   |                   |                   |
| 2 Detyrime ndaj Institucioneve te kredise                       |                   |                   |
| 3 Arketime ne Avance per porosi                                 |                   |                   |
| 4 Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit                   |                   |                   |
| 5 Deftesa te pagueshme  |                   |                   |
| 6 Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit             |                   |                   |
| 7 Te tjera te pagueshme   |                   |                   |
| <b>Te pagueshme per shpenzime te konstatuara</b>                |                   |                   |
| <b>Te ardhura te shtyra</b>                                     |                   |                   |
| <b>Provizione</b>   |                   |                   |
| <b>TOTAL I DETYRIMEVE AFATGJATA ( II )</b>                      | <b>0</b>          | <b>0</b>          |
| <b>TOTAL I DETYRIMEVE ( I + II )</b>                            | <b>18,243,095</b> | <b>7,413,957</b>  |
| <b>III KAPITALI</b>   |                   |                   |
| <b>Kapitali dhe rezervat</b>                                    |                   |                   |
| <b>Kapitali I nenshkuar</b>                                     | 6,000             | 6,000             |
| <b>Primi I lidhur me kapitalin</b>                              |                   |                   |
| <b>Rezerva rivleresimi</b>                                      |                   |                   |
| <b>Rezerva te tjera</b>   |                   |                   |
| Rezerva statusore   | 3,690,417         |                   |
| Rezerva ligjore   |                   |                   |
| Rezerva te tjera  |                   |                   |
| <b>Fitimet e pashperndara</b>                                   | 0                 | 442,219           |
| <b>Fitimi ( Humbja ) e vitit</b>                                | 35,262,095        | 13,690,417        |
| <b>TOTAL I KAPITALIT ( III )</b>                                | <b>38,958,512</b> | <b>14,138,636</b> |
| <b>TOTAL I DETYRIMEVE KAPITALIT ( I,II,III )</b>                | <b>57,201,607</b> | <b>21,552,593</b> |



**Kreatx Shpk**  
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUdhËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME  
31 DHJETOR 2016 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHË SHKRUHET

**Pasqyra e Të Ardhura dhe Shpenzimeve**

| Nr    | Pershkrimi i Elementeve  | Viti 2016         | Viti 2015         |
|-------|--|-------------------|-------------------|
| 1     | Te ardhura nga aktiviteti I shfrytezimit   | 112,457,042       | 77,983,976        |
| 2     | Te ardhura te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit  |                   |                   |
| 3     | Ndryshimet ne inventarin e produkteve te gatshme dhe prodhimet ne proces<br>Puna e Kryer nga njesia ekonomike dhe e kapitalizuar |                   |                   |
| 4     | Lendet e para dhe Materialet e konsumuara  | 9,923,931         | 7,643,552         |
| 5     | Shpenzimet e personelit  | 17,745,431        | 31,181,634        |
| (i)   | -pagat e personelit dhe shperblime   | 15,552,293        | 29,171,071        |
| (ii)  | -shpenzimet per sigurimet shoqerore dhe shendetesore   | 2,161,074         | 1,523,363         |
| (ii)  | -shpenzimet te tjera te lidhura me punonjesit  | 32,064            | 487,200           |
| 6     | Zhvleresim I Aktiveve Afatgjata Materiale  | 721,898           | 359,551           |
| 7     | Shpenzime te tjera shfrytezimi   | 42,397,812        | 22,654,889        |
| (i)   | Furnitura, Nentrajtme dhe Sherbime   | 42,101,097        | 22,535,564        |
| (ii)  | Tatime, Taksa e Derdhje te Ngjashme  | 138,505           |                   |
| (iii) | Sherbime te tjera  | 158,210           | 119,325           |
| 8     | Totali i shpenzimeve ( shuma 4 - 7 )   | 70,789,072        | 61,839,626        |
| 9     | <b>Fitimi apo humbja nga veprimtaria kryesore ( 1+2+/-3-8)</b>   | <b>41,667,970</b> | <b>16,144,350</b> |
| 10    | Te ardhurat dhe shpenzimet financiare  | (155,233)         | (37,978)          |
| 10.1  | Te ardhurat dhe shpenzimet financiare nga investime te tjera financiare afatgjata  |                   |                   |
| 10.2  | Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesat   | 916               | 11,714            |
| 10.3  | Fitimet ( Humbjet ) nga kursi i kembimit   | (245,812)         | (1,477)           |
| 10.4  | Te ardhura dhe shpenzime te tjera financiare   | 89,663            | (48,215)          |
| 11    | <b>Fitimi ( Humbja ) para tatimit</b>  | <b>41,512,737</b> | <b>16,106,373</b> |
| 12    | Shpenzimet e tatimit mbi fitimin   | 6,250,642         | 2,415,956         |
| 13    | <b>Fitimi ( Humbja ) neto e vitit financiar ( 14-15)</b>   | <b>35,262,095</b> | <b>13,690,417</b> |

Pasqyrat Financiare **Kreatx shpk** janë aprovuar nga Drejtimi i Shoqerise  
Më datë 29 Mars 2017

Administrator

Enor NAKUCI





**Kreatx Shpk**  
 PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME  
 31 DHJETOR 2016 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

**Pasqyra e flukseve monetare**

| Pasqyra e fluksit monetar - Metoda indirekte   | Viti<br>2016       | Viti<br>2015      |
|--|--------------------|-------------------|
| <b>Fluksi monetar nga veprimtarite e shfrytezimit</b>  |                    |                   |
| Fitimi para tatimit  | 41,512,737         | 16,106,373        |
| Rregullime per:  |                    |                   |
| <i>Amortizimin</i>   | 721,898            | 359,551           |
| Rritje/renie ne tepricen e kerkesave te arketueshme nga aktiviteti, si dhe kerkesave te arketueshme te tjera | (37,439,089)       | (2,219,378)       |
| Rritje/renie ne tepricen e inventarit  | 1,055,996          | (1,055,996)       |
| Rritje/renie ne tepricen e detyrimeve, per tu paguar nga aktiviteti  | 10,829,138         | (2,358,931)       |
| <b>MM te perfituara nga aktivitetet</b>  | <i>16,680,681</i>  | <i>10,831,618</i> |
| Tatim mbi fitimin I paguar   | (5,999,107)        | (2,415,956)       |
| <b>MM neto nga aktivitetet e shfrytezimit</b>  | <b>10,681,574</b>  | <b>8,415,662</b>  |
| <b>Fluksi monetar nga veprimtarite investuese</b>  |                    |                   |
| Blerje aksionesh dhe letra te tjera me vlere   |                    |                   |
| Blerjet e aktiveve afatgjata materiale   | 3,694,113          | 1,525,118         |
| Shitja e aktiveve afatgjata materiale  |                    |                   |
| <i>MM neto te perdorura ne veprimtarite investuese</i>   |                    |                   |
| <b>Fluksi monetar nga aktivitetet financiare</b>   |                    |                   |
| Te ardhurat nga ementimi I kapitalit aksionar  |                    |                   |
| Dividende te paguar  | 10,442,219         | 3,174,204         |
| <i>MM neto e perdorur ne veprimtarite financiare</i>   |                    |                   |
| <b>Rritja/renia neto e mjeteve monetare</b>  | <b>(3,454,759)</b> | <b>3,716,341</b>  |
| <b>Mjetet monetare ne fillim te periudhes kontabel</b>   | <b>4,803,315</b>   | <b>1,086,974</b>  |
| <b>Mjetet monetare ne fund te periudhes kontabel</b>   | <b>1,348,556</b>   | <b>4,803,315</b>  |



**Kreatx Shpk**  
**PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME**  
**31 DHJETOR 2016 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE**

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

**Pasqyra e ndryshimeve të kapitalit**

|                                     | Kapitali aksionar | Rezerva statore | Rezerva ligjore | Rezerva te tjera | Fitimi USHTRIMIT  | TOTALI            |
|-------------------------------------|-------------------|-----------------|-----------------|------------------|-------------------|-------------------|
| <b>Pozicioni me 31 dhjetor 2014</b> | <b>6,000</b>      | <b>-</b>        | <b>-</b>        | <b>442,219</b>   | <b>3,174,204</b>  | <b>3,622,423</b>  |
| Fitimi neto per periudhen kontabel  |                   |                 |                 |                  | 13,690,417        | 13,690,417        |
| Dividentet e paguar                 |                   |                 |                 |                  | (3,174,204)       | (3,174,204)       |
| Rritja rezerves kapitalit           |                   |                 |                 |                  |                   | -                 |
| Rritja e rezervave ligjore          |                   |                 |                 |                  |                   | -                 |
| Emetimi kapitali aksionar           |                   |                 |                 |                  |                   | -                 |
| <b>Pozicioni me 31 dhjetor 2015</b> | <b>6,000</b>      | <b>-</b>        | <b>-</b>        | <b>442,219</b>   | <b>13,690,417</b> | <b>14,138,636</b> |
| Fitimi neto per periudhen kontabel  |                   |                 |                 |                  | 35,245,203        | 35,245,203        |
| Dividentet e paguar                 |                   |                 |                 | (442,219)        | (13,690,417)      | (14,132,636)      |
| Rritja rezerves kapitalit           |                   |                 |                 |                  | 3,690,417         | 3,690,417         |
| Rritja e rezervave ligjore          |                   |                 |                 |                  |                   | -                 |
| Emetimi kapitali aksionar           |                   |                 |                 |                  |                   | -                 |
| <b>Pozicioni me 31 dhjetor 2016</b> | <b>6,000</b>      | <b>-</b>        | <b>-</b>        | <b>-</b>         | <b>38,935,620</b> | <b>38,941,620</b> |



## 2. Parimet e përgatitjes së pasqyrave financiare

### Sqarim:

Dhenia e shenimeve shpjeguese në këtë pjesë është e detyrueshme sipas SKK2 i përmirësuar. Plotesimi i të dhenave të kësaj pjesë duhet të bëhet sipas kërkesave dhe strukturës standarte të përcaktuara në SKK 2 të përmirësuar. Radha e dhenies së spjegimeve duhet të jetë:

- a) Informacion i përgjithshëm dhe politikat kontabel
- b) Shenimet që shpjegojnë zërat e ndryshëm të pasqyrave financiare
- c) Shenimet e tjera shpjeguese

### **Informacion i përgjithshëm**

1. Kuadri ligjor : Ligji 9228 dt.29.04.2004 “Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”
2. Kuadri kontabel i aplikuar : Standartet Kombetare të Kontabilitetit në Shqipëri .(SKK2)
3. Baza e përgatitjes së PF : Mbi bazën e konceptit të materialitetit. (SSK 1, 1-3)
4. Parimet bazë për përgatitjen e Pasqyrave Financiare : (SSK 1; 40-90)
  1. Parimi i njësisë ekonomike : mban në llogarite e saj aktivet, detyrimet dhe transaksionet ekonomike të vetat
  2. Parimi i vijimesisë : veprimtaria ekonomike e njësisë sone raportuese është e siguruar duke mos pasur në plan ose nevojë ndërprerjen e aktivitetit të saj
  3. Kuptueshmëria e Pasqyrave Financiare është realizuar në masën e plote për të qenë të qarta dhe të kuptueshme për përdorues të jashtëm që kanë njohuri të përgjithshme të mjaftueshme në fushën e kontabilitetit
  4. Materialiteti është vlerësuar nga ana jone dhe në bazë të tij Pasqyrat Financiare janë hartuar vetëm për zëra materiale.
  5. Besueshmëria për hartimin e Pasqyrave Financiare është e siguruar pasi nuk ka gabime materiale duke zbatuar parimet e mëposhtme:
    - Parimin e paraqitjes me besnikëri
    - Parimin e përparesisë së përmbajtjes ekonomike mbi formën ligjore
    - Parimin e paanshmerisë pa asnjë influencim të qëllimshëm
    - Parimin e maturisë pa optimizem të tepruar , pa nën e mbivlerësim të qëllimshëm
    - Parimin e plotesisë duke paraqitur një pamje të vertete e të drejte të PF
    - Parimin e qëndrueshmërisë për të mos ndryshuar politikën e metodat kontabel
    - Parimin e krahasueshmërisë duke siguruar krahasimin midis dy periudhave

### **2.1 Transaksionet me monedhat e huaja**

a. Konvertimi i transaksioneve në monedhë të huaj

*i) Monedha funksionale dhe monedha e paraqitjes*

Zërat e përfshirë në pasqyrat financiare vlerësohen duke përdorur monedhën e mjedisit ekonomik kryesor në të cilin operon njësi (“monedha funksionale”). Pasqyrat financiare në Shqipëri paraqiten në Lekë (All), e cila është monedha funksionale dhe monedha e paraqitjes.

b. Transaksionet dhe tepricat



**Kreatx Shpk**  
**PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUHDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME**  
**31 DHJETOR 2016 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE**

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Në fund të periudhës kontabël, aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit të kësaj date të shpallur nga BSH. Diferencat nga konvertimi, fitimet ose humbjet, regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, në zërin “të tjera të ardhura (shpenzime) financiare”.

Kurset e këmbimit të përdorura për konvertimin e zërave monetarë në datën 31 Dhjetor 2016 janë:

| Data / Monedha | 31 Dhjetor 2016 | 31 Dhjetor 2015 |
|----------------|-----------------|-----------------|
| Euro           | 135.23          | 137.28          |

## 2.2 Mjetet monetare

Në këtë grup të aktiveve paraqitet gjendja e mjeteve monetare në llogaritë bankare dhe në arkat e shoqërisë. Një paraqitje e përmblodhur e tyre jepet në tabelën vijuese:

| Mjete monetare         | Viti 2016        | Viti 2015        |
|------------------------|------------------|------------------|
|                        | Në lekë          | Në lekë          |
| Llogari bankare ne Lek | 774,836          | 3,953,315        |
| Mjete Monetare ne arke | 573,720          | 850,000          |
| <b>Totali</b>          | <b>1,348,556</b> | <b>4,803,315</b> |

Konvertimi i gjendjes në monedhë të huaj në arkë dhe bankë është bërë me kursin e datës 31.12 të shpallur nga Banka e Shqipërisë. Diferencat e rezultuara nga rivlerësimi i likuiditeteve në monedhë të huaj janë sistemuar në rezultat.

## 2.3 Llogari Kërkesa të arkëtueshme

Në këtë zë paraqiten kërkesat ndaj klientëve gjendje të paarkëtuar në 31 Dhjetor 2015. Një paraqitje e përbërjes së kërkesave të arkëtueshme ndaj klientëve jepet në tabelën vijuese:

| Llogari/Kerkesa te arketueshme | Viti 2016         | Viti 2015        |
|--------------------------------|-------------------|------------------|
|                                | Në Lekë           | Në Lekë          |
| Kliente                        | 50,286,637        | 4,569,474        |
| <b>Totali</b>                  | <b>50,286,637</b> | <b>4,569,474</b> |

## 2.4 Inventarët

Inventarët njihen, në përputhje me përcaktimet e bëra në SKK 4 “Inventarët”, kur shoqëria i kontrollon apo zotëron ato ekonomikisht apo ligjërisht, kur mbart të gjitha rreziqet dhe përfitimet në lidhje me to, dhe kur kostoja matet në mënyrë të besueshme. Në hyrje inventarët e mallrave dhe materialeve vlerësohen me koston e tyre që përfshin tërësinë e çmimeve të blerjes dhe të shpenzimeve të bëra deri në sjelljen e tyre në shoqëri kur këto kosto mund të identifikohen me besueshmëri. Në bilanc inventarët paraqiten të vlerësuara më të voglën midis koston dhe vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme është e ardhura e parashikuar nga shitja në një periudhë normale të aktivitetit minus koston e parashikuara të shitjes.

Shoqëria përdor metodën kontabël të inventarizimit të vazhduar dhe metodën e koston mesatare për matjen e inventarëve gjendje. Në datën e ndërtimit të PF shoqëria ka gjykuar që kosto e inventarit është më e ulët se vlera neto e realizueshme prandaj janë paraqitur të vlerësuara me koston mesatare të tyre. Në datën 31 Dhjetor 2016 shoqëria nuk ka inventare gjendje.

## 2.5 Aktivet e Afatgjata Materiale (AAM)

### *(i) Njohja dhe vlerësimi*

AAM vlerësohen në hyrje me kosto. AAM paraqiten në Bilanc me koston e amortizuar (koston historike minus amortizimin e akumuluar minus zhvlerësimin nga ulja e vlerës (nëse ka). Kosto historike përfshin shpenzimet që i përkasin direkt blerjes së elementëve të AAM. Koston e kryera më vonë përfshihen në vlerën e mbartur të aktivitetit ose njihen si një aktiv më vete, sipas rastit, vetëm nëse është e mundur që ky element të sjellë hyrje të përfitimeve të ardhshme ekonomike në shoqëri dhe kostoja e këtij elementi të mund të matet me besueshmëri. Të gjitha shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimit regjistrohen si shpenzime në periudhën që ato kryhen dhe paraqiten në zërin e shpenzimeve operative. AAM paraqiten në bilanc me vlerën kontabël neto nga amortizimi

### *(ii) Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve afatgjata jomateriale llogaritet dhe njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e vlerës së mbetur, me norma të cilat janë të përafërta me jetegjatesinë mesatare të parashikuar të përdorimit.

Gjendja dhe shtesat e pakësimet e Aktiveve Afatgjata Materiale dhe e amortizimeve të tyre gjatë vitit 2016 paraqiten si në tabelën vijuese:



**Kreatx Shpk**  
**PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME**  
**31 DHJETOR 2016 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE**

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHË SHKRUHET

|                          | Gjendje<br>31/12/2015 | Shtesa           | Pakesime | Gjendje<br>31/12/2016 |
|--------------------------|-----------------------|------------------|----------|-----------------------|
| Mjete transporti         | 0                     |                  |          | -                     |
| Mobilje dhe pajisje zyre | 962,359               | 1,909,357        |          | 2,871,716             |
| Pajisje informative      | 1,595,233             | 1,784,757        |          | 3,379,990             |
|                          | 0                     |                  |          | -                     |
| <b>TOTALI</b>            | <b>2,557,592</b>      | <b>3,694,113</b> | <b>0</b> | <b>6,251,705</b>      |

**Amortizimi A.A.Materiale 2016**

| Emertimi                 | Gjendje<br>31/12/2015 | Shtesa         | Pakesime | Gjendje<br>31/12/2016 |
|--------------------------|-----------------------|----------------|----------|-----------------------|
| Mjete transporti         | -                     |                |          | -                     |
| Mobilje dhe pajisje zyre | 96,236                | 192,472        | 0        | 288,708               |
| Pajisje informative      | 411,358               | 529,427        | 0        | 940,785               |
|                          |                       |                |          | -                     |
| <b>TOTALI</b>            | <b>507,594</b>        | <b>721,898</b> | <b>0</b> | <b>1,229,492</b>      |

**Vlera Kontabel Neto e A.A.Materiale**

| Emertimi                 | Gjendje<br>31/12/2015 | Shtesa           | Pakesime | Gjendje<br>31/12/2016 |
|--------------------------|-----------------------|------------------|----------|-----------------------|
| Mjete transporti         | -                     |                  |          | -                     |
| Mobilje dhe pajisje zyre | 866,123               | 1,716,885        |          | 2,583,008             |
| Pajisje informative      | 1,183,875             | 1,255,330        |          | 2,439,205             |
|                          |                       |                  |          | -                     |
| <b>TOTALI</b>            | <b>2,049,998</b>      | <b>2,972,215</b> | <b>0</b> | <b>5,022,213</b>      |

## 2.6 Detyrimet

Shoqëria i klasifikon detyrimet në afatshkurtra dhe afatgjata.

Detyrimet afatshkurtra klasifikohen në Detyrime tregtare/Llogari të pagueshme ndaj furnitorëve dhe detyrime të tjera.

Llogaritë e pagueshme dhe detyrimet tregtare të tjera njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas në bilanc paraqiten të vlerësuara me koston e amortizuar.

Në detyrimet e tjera përfshihen detyrimet jotregtare dhe huamarrjet përveç llogarive të pagueshme dhe detyrimeve të tjera tregtare.



**Kreatx Shpk**  
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME  
31 DHJETOR 2016 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

---

Detyrimet ndaj shtetit për tatimet dhe për kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore janë paraqitur me shumën e tyre të llogaritur sipas kërkesave ligjore në fuqi më datën e ndërtimit të pasqyrave financiare

Huamarrjet afatshkurtër njihen fillimisht me vlerën e drejtë, pa përfshirë kostot e transaksionit. Huat më pas vlerësohen me koston e amortizuar: çdo diferencë midis ripagesave (neto nga kostot e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huas.

Huat klasifikohen si detyrime afatshkurtra, me përjashtim në rast se Shoqëria ka një të drejtë të pakushtëzuar për të shtyrë shlyerjen e detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit kontabël.

Detyrimet afatgjata vlerësohen në hyrje me kosto dhe paraqiten në bilanc të vlerësuar me koston e amortizuar. Çdo diferencë midis ripagesave (neto nga kostot e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huas duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shoqëria ka gjendje hua afatgjata në fund të periudhës raportuese.

## **2.7 Të ardhurat dhe shpenzimet**

Të ardhurat nga shitja e mallrave, produkteve dhe shërbimeve njihen kur ekziston një marrëveshje e vazhdueshme me klientin, dorëzimi është realizuar apo shërbimi është kryer, dhe rreziqet e përfitimit e pronësisë së mallit apo produktit i janë transferuar klientit, vlera e të ardhurave mund të matet me besueshmëri dhe është e mundur që përfitimet që lidhen me transaksionin mund të hyjnë në Shoqëri. Të ardhurat nga shërbimet e kryera njihen kur janë kryer shërbimet pavarësisht nëse ato janë faturuar, arkëtuar ose jo.

Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëherë kur ngjarja detyruese ka ndodhur dhe shoqëria pret të dalin aktive për shlyerjen e tyre në të ardhmen. Shoqëria ka zbatuar parimin e krahasimit të të ardhurave me shpenzimet brenda të njëjtës periudhë. Shpenzimet njihen kur kryhen dhe realizohen të ardhura prej tyre pavarësisht nëse janë faturuar apo paguar ato.

### **2.7.1 Shpenzime për personelin**

#### *(i) Kontributet për sigurime shoqërore dhe të ngjashme*

Shoqëria, gjatë aktivitetit të saj normal, kryen pagesa në emër të saj dhe të punonjësve të saj për kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në pajtim me legjislacionin në fuqi. Kostot përkatëse të bëra në emër të Shoqërisë ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave me ndodhjen e tyre.

#### *(ii) Leje e zakonshme e paguar*

Shoqëria i njeh si një shpenzim personeli dhe si detyrime ato kosto që lidhen me lejen e zakonshme që u takon punonjësve për periudhën kur në fakt merret leja e zakonshme prej tyre.

## **2.8 Provizionet**

Provizioni njihet kur Shoqëria ka një detyrim aktual që ka lindur nga një ngjarje e shkuar, shlyerja e të cilit pritet të shoqërohet me dalje të burimeve dhe mund të behet një vlerësim relativisht i sakte i shumës së detyrimit.

**Kreatx Shpk**  
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME  
31 DHJETOR 2016 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE.. PERNDRYSHE SHKRUHET

### 2.9 Tatimi aktual mbi fitimin

Shoqëria nuk zbaton kërkesat e SKK 11 për tatimin aktual mbi të ardhurat. Shoqëria për llogaritjen e tatimit aktual mbi të ardhurat bazohet në normën e tatimit që përcaktohet në ligjet për tatimet që janë në fuqi në datën e ndërtimit të bilancit kontabël. Fitimi i tatueshëm është llogaritur duke u bazuar në rezultatin kontabël dhe duke e korrigjuar atë me shpenzimet e panjohura sipas përcaktimit të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”. Menaxhimi vlerëson periodikisht gjendjen lidhur me tatimin e rimbursueshëm duke u bazuar në situatat në të cilat rregullimet tatimore që zbatohen janë subjekt i interpretimit dhe përcakton provizione kur e shikon të përshtatshme bazuar në shumat që parashikon të paguajë ndaj zyrës së tatimeve.

Shoqëria ka rezultuar me një fitim kontabel para tatimit prej 41,512,737 leke. Për llogaritjen e rezultatit tatimor të vitit 2016 shoqëria ka bërë rregullimet e nevojshme fiskale.

Llogaritja e rezultatit fiskal për gjithë vitin 2016 paraqitet si në tabelën vijuese:

|                                    |            |
|------------------------------------|------------|
| Fitimi para tatimit                | 41,512,737 |
| Shpenzime të panjohura             | 158,210    |
| Humbje nga mosarketimi i klientëve | -          |
| Shpenzime të tjera të panjohura    | 158,210    |
| Fitimi i tatueshëm                 | 41,670,947 |
| Tatim fitimi 15 %                  | 6,250,642  |
| Fitimi neto I bilancit             | 35,262,095 |

### 3.13 Ngjarjet mbas datës së bilancit

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së bilancit që do të ishte e nevojshme të paraqiteshin si rregullime ose informacione shtesë në këto pasqyra financiare.

Administratori  
Enor Nakuci

